

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Sabedin Mushica, sekretaren juridike Adelina Brestovci, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëseve H. K. dhe E. K. që të dyja nga Gjilani të cilat me autorizim i përfaqëson av. Hamdi Jashari nga Gjilani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Adnan Pacolli, jurist nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit material dhe jo material, pas seancës publike të datës 26.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET PJESËRISHT e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëseve H. K. dhe E. K. që të dyja nga Gjilani, e ushtruar ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, dhe

I. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që paditëseve H. K. dhe E. K. që të dyja nga Gjilani, pjesërisht t’ia kompensojë dëmin jo material dhe material të shkaktuar, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 07.08.2014, në Gjilan, ku është shkaktuar aksident trafiku në rrugën e Koretishtës më saktësisht te Furra “Dora”, ku shkaktar i aksidentit ishte njësia A e cila duke mos ia përshtatur shpejtësinë mjetit të tij dhe kushteve të rrugës godet këmbësoret H. K. dhe E. K. të cilat ishin duke lëvizur skajit të rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes me çrast pësojnë lëndime trupore

a) Për paditësen H. K. për dëmin jo material edhe atë ;

- në emër të të gjitha dhimbjeve fizike shumën prej 4,000.00 €
- për zvogëlim të aktivitetit jetësor për 15% shumën prej 4,500.00 €
- për shëmtim në shkallë të mesme shumën prej 1,200.00 €
- në emër të frikës së pësuar të të gjitha intensiteteve shumën prej 1,800.00 €

Të gjitha këto për dëmin jo material edhe atë për H. K. në shumë prej 11,500.00 € (njëmbëdhjetë mijë e pesëqindtë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, edhe atë prej 26.10.2017 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimit të përmbarrimit të dhunshëm.

b) Për paditësen E. K. për dëmin jo material edhe atë ;

- në emër të të gjitha dhimbjeve fizike shumën prej 2,000.00 €
- në emër të frikës së pësuar të të gjitha intensiteteve shumën prej 1,500.00 €
- Në emër të shëmtimit shumën prej 1,000.00 €

Të gjitha këto për dëmin jo material edhe atë për E. K. në shumë prej 4,500.00€ (katërmijë e pesëqindtë euro) me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, edhe

atë prej 26.10.2017e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm.

II. REFUZHET e pa bazuar në ligj pjesa tjetër e kërkesëpadisë për paditësen H. K. në emër të dëmit jo material e kërkuar më shumë se shumat e gjykuara edhe atë në shumë prej 5,500.00 € (pesëmijë e pesëqindtë euro).

III. REFUZHET e pa bazuar me ligj kërkesa e paditëses H. K. me të cilën ka kërkuar që në emër të dëmit material edhe atë për ndihmën e personit të tretë shumën në lartësi prej 600€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 800€.

IV. REFUZHET e pa bazuar në ligj pjesa tjetër e kërkesëpadisë për paditësen E. K. në emër të dëmit jo material e kërkuar më shumë se shumat e gjykuara edhe atë në shumë prej 1,500.00€ (njëmijë e pesëqind euro)

V. REFUZHET e pa bazuar me ligj kërkesa e paditëses E. K. me të cilën ka kërkuar që në emër të dëmit material edhe atë për ndihmën e personit të tretë shumën në lartësi prej 100€, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 150€.

VI. DETYROHET e paditura që paditëseve t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore në shumë prej 969.00€ afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1.Kronologjia e çështjes

1.1.Paditëset H. K. dhe E. K. nga Gjilani përmes përfaqësuesit të tyre av.Hamdi Jashari nga Gjilani, më datë 08.12.2014, kanë ushtruar padi për kompensimin e dëmit material dhe jo material në vlerë 85,901.00 €.

1.2.Pas pranimit të padisë, kjo gjykatë duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, palës së paditur iu ka dërguar padinë, në mënyrë që e njëjta të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e saj. Në përgjigjen ne padi te datës 17.11.2016, e paditura ka propozuar që padisë ti bashkëngjiten aktvendimi apo aktgjykimi mbi kundërvajtje i plotfuqishëm penal, faturat në origjinal mbi shpenzimet e shërimit të cilat fatura duhet të përmbajnë emrin e subjektit juridik, numrin e biznesit si dhe shënimet e paditësit në faturë, dokumentacionin mjekësor të kohës më të re (raporti i emergjencës në origjinal, fotografitë rengologjike, analiza laboratorike, mendimet e radiologut, dëshmi për rehabilitimin në qendrat rehabilituese), si dhe e ka rezervuar të drejtën që në seancë gjyqësore të rideklarohet për bazën dhe lartësinë e kërkesëpadisë.

2.Kompetenca dhe juridiksioni

Gjykata vlerëson se konform nenit 29 lidhur me nenin 47 të LPK-së është kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike civile.

3.Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

3.1. Përfaqësuesi i paditëseve në seancën përgatitore¹, në shqyrtimin gjyqësor² dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë së përmirësuar duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë si të bazuar si dhe ta obligojë të paditurën t'ia bëjë kompensimin paditëseve H. K. dhe E. K. në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore edhe atë në emër të taksës për padi shumë prej 264.00€, në emër të ekspertizave mjekësore shumë prej 300.00€ dhe në emër të përfaqësimit të kësaj seance gjyqësore shumë prej 405.00€ sipas TA.

3.2. Përfaqësuesi i të paditurës në seancën përgatitore³ në shqyrtimin kryesor⁴ dhe në fjalën përfundimtare i ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh ofertën e të paditurës dhe se çdo shumë e kërkuar nga oferta e dhënë nga ana e të paditurës, të refuzohet si e pa bazuar.

4. Deklaratat e ekspertëve

4.1. Sipas ekspertizës së datës 08.03.2017, nga eksperti gjyqësor Dr. Qemajl Rexhepi –Psikiatër, ku e ka bërë ekzaminimin e drejtëpërdrejt dhe në bazë të tërë dokumentacionit që kanë qenë në shkresat e lëndës për paditësen E. K., rezulton se: paditësja E. K. në aksidentin e trafikut të datës 07.08.2014, ka pësuar lëndime trupore në formë të ndrydhjeve të kokës dhe trupit pastaj gërvishje në regjionin gluteal majtas dhe frontal majtas që specialisti i ORL-së e ka përshkruar si plagë çarëse ndrydhëse, sipas kësaj ekspertize ka rezultuar se e lënduara frikë primare të intensitetit të lartë ka pasur 2-3 minuta, frikë të intensitetit të lartë 2-3 orë, frikë të intensitetit mesatar- frikë sekondare ka pasur 2 javë. Pasoja të mëvonshme ka pasur manifestim të stresit akut, probleme me gjumin herë pas here si dhe brengosje. Sipas ekspertizës së datës 05.10.2017, nga eksperti gjyqësor Dr. Qemajl Rexhepi-Psikiatër, ku e ka bërë ekzaminimin e drejtëpërdrejt dhe në bazë dokumentacionit mjekësor, për

¹ I ka propozuar gjykatës të caktoj ekspert nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë për vlerësimin e shkallës së lëndimeve për paditësen H. K. dhe E. K., edhe atë Ortopedi- traumatolog.

² Në seancën kryesore të mbajtur me dt. 26.10.2017 përfaqësuesi i paditëseve ka bërë përmirësimin e kërkesëpadisë, ashtu që për paditësen H. K. në emër të dëmit jo material, për dhimbjet fizike të të gjitha intensiteteve ka kërkuar shumë në lartësi prej 6.500.00 €, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumë prej 6.000.00 €, për shëmtimin në shkallë të mesme shumë prej 2.000.00 €, për frikën e pësuar për të gjitha intensitetet shumë prej 2.500.00 €, të gjitha këto në emër të dëmit jo material në shumë të përgjithëshme në lartësi prej 17.000.00 €, me kamat prej 8% në vit, nga dita e marrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive. Ndërsa në emër të dëmit material për ndihmën e personit të tretë ka kërkuar shumë në lartësi prej 600.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumë në lartësi prej 800.00 €, në shumë të përgjithëshme në emër të dëmit material ka kërkuar shumë prej 1.400.00 €, me kamat prej 8% në vit, nga dita e ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive. Në emër të paditëses E. K. në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike të të gjitha intensiteteve ka kërkuar shumë në lartësi prej 3.000.00 €, në emër të frikës së pësuar për të gjitha intensitetet shumë në lartësi prej 2.000.00 €, në emër të shëmtimit në shkallë të lehtë shumë në lartësi prej 1.000.00 €, në total në emër të dëmit jo material shumë në lartësi prej 6.000.00€ me kamat prej 8% në vit, duke filluar nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive. Në emër të dëmit material edhe atë për ndihmën e personit të tretë kërkoj shumë në lartësi prej 100.00 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumë në lartësi prej 150.00 €, në total në emër të dëmit material shumë në lartësi prej 250.00 €, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

³ Ka propozuar që për paditësen E. K. të arrijnë pajtim gjyqësor duke e ofruar shumë në lartësi prej 650 €, për të gjitha kategoritë e dëmit, kurse sa i përket të paditurës H. K. kontestuese është baza juridike edhe atë deri në sigurimin e prova mjekësore.

⁴ E ka kontestuar përmirësimin e kërkesëpadisë për shkak se shumtë e kërkuara janë shumë të larta, të njëjtat nuk janë në përputhje me natyrën e lëndimeve e që kanë pësuar paditëset në ditën e aksidentit dhe gjithashtu nuk janë në harmoni me mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjekësor dhe si të tilla janë jashtë qdo praktike gjyqësore. Epaditura është e gatëshme që për paditësen H. K. të ofroj shumë prej 4.800.00 €, dhe për paditësen E. K. shumë prej 1.200.00 €, për të gjitha kategoritë e dëmit.

paditësen H. K., rezulton se: me 07 Gusht ka pësuar aksident në trafik në rrugën e Koretishtës në Gjilan te Furra Dora, si këmbësore duke pësuar lëndime si ndrydhje të kokës me plagë prerëse në regjionin zverkor të djathtë, ndrydhje me gjakderdhje në regjionin e belit, thyerje të pllatosë tibiale të gjurit të djathtë, pasoja imediate ka pasur frikë të intensitetit shumë të lartë- frikë primare 3-4 minuta, frikë të intensitetit mesatar- frikë sekondare 2 javë, manifestim të stresit akut, probleme të gjumit herë pas here, probleme me harrës janë prezent, probleme me përqendrim ndonjëherë, nevojë të mëtejshme për trajtim mjekësor herë pas here me terapi fizikale.

4.2. Sipas ekspertizës së datës 09.08.2017 e kryer nga eksperti ortoped –traumatolog Dr. Xhemajl Selmani, ku e ka bërë ekzaminimin e drejtpërdrejt dhe në bazë të tërë dokumentacionit rezulton se: paditësja E. K. në aksidentin e trafikut të dt. 07.08.2014, ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe sipas kësaj ekspertize ka rezultuar se e lënduara ka pësuar ndrydhje të kokës dhe të trupit, gërvishtje të pjesës së sipërme të kofshës së majtë dhe plagë prerëse dërmishëse në pjesën ballore- mes dy vetullave dhe cepin e syrit të majtë si dhe në mbi gjurin e majtë, lëndimi trupor i pësuar karakterizohet si lëndim i lehtë trupor, sipas kësaj ekspertize ka rezultuar se e lënduara dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë ka pasur 20 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë ka pasur 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm ka pasur për 14 ditë (koha e nevojshme për rikuperimin e organizmit nga lëndimet e lehta trupor dhe plagët prerëse), dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka pasur për rreth një muaj pas aksidentit, gjatë sforcimit fizik dhe ndryshimeve klimatike, shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të lehtë për shkak të vrazave të mbetura në mes të vetullave 0,5 cm, në cepin e syrit të majtë 1cm dhe mbi gjurin e majtë 3cm, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm mjekësor nuk ekziston, ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 10 ditë, ndihmë e cila konsiston në përgatitjen dhe ofrimin e ushqimit si dhe mbajtjen e higjienës personale, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 21 ditë i pasur me vitamina, minerale, karbohidrate, proteina dhe albumina si dhe rehabilitimi fizioterapeutik- klimatik ka qenë i nevojshëm për 10 ditë brenda vitit të parë pas aksidentit. Sipas po kësaj ekspertize për paditësen Hide Kosumi ku e ka bërë ekzaminimin e drejtpërdrejt dhe në bazë të tërë dokumentacionit u konstatua se në këtë aksident ka pësuar ndrydhje të kokës me plagë prerëse në regjionin zverkor të djathtë, ndrydhje me gjak mbledhje në regjionin e belit, thyerje e pllatosë tibiale të gjurit të djathtë, lëndimi trupor karakterizohet si lëndim i rëndë i cili ka shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 40 minuta duke llogaritur momentin e aksidentit, transportin, deri në arritjen e pacientit në qendrën emergjente në Gjilan, procedurat diagnostifikuese, deri në fillimin e dhënies së terapisë adekuate kundër dhimbjes, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për 48 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 42 ditë koha e nevojshme për fillimin e konsolidimit primar kockor – në raport me moshën, dhimbje fizike të intensitetit të ulët sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësen, ka edhe sot e kësaj dite të cilat manifestohen si dhimbje të vazhdueshme të belit (kryqëza) dhe gjurit të djathtë, dhimbje koke me ushtimë të cilat shtohen gjatë sforcimit fizik dhe ndryshimeve klimatike, shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të mesme për shkak të vrazave të mbetura në pjesën zverkore të djathtë të kokës me gjatësi 3cm dhe vrazat operatorë e gjurit të djathtë me gjatësi prej 12 cm, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallën prej 15%, për shkak të artrozës së gjurit të djathtë me kufizim të lëvizjeve të tij në shkallë të mesme- pika 2.3.3 b e tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, e miratuar nga MSH dhe BQK, ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 90 ditë (në raport me moshën), ndihmë e cila konsiston në përgatitjen dhe ofrimin e

ushqimit si dhe mbajtjen e higjienës personale, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 120 ditë i pasur me vitamina, minerale, karbohidrate, proteina dhe albumina, rehabilitimi fizioterapeutik-klimatik ka qenë i nevojshëm për 50 ditë brenda 2 viteve pas aksidentit (në raport me moshën) 30 ditë për vitin e parë dhe 20 ditë për vitin e dytë pas aksidentit.

5.Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

5.1. Gjykata ka lexuar- dhe administruar këto prova: Raporti nga Spitali Regjional i Gjilanit me numër 12692, i dt. 07.08.2014, konstatimi i ekspertit ortoped i datës 09.08.2017, konstatimi i ekspertit psikiatër i datës 08.03.2017 dhe 05.10.2017, fletëlëshimi nga Spitali Regjional në Gjilan, me numër 11-214, i dt. 18.08.2014.

6. Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

6.1. Se më datë 07.08.2014 në Gjilan në rrugën e Koretishtës më saktësisht te furra Dora ka ndodhur aksident trafiku ku deri te aksidenti ka ardhur atëherë kur njësia A duke lëvizur nga drejtimi i qytetit në drejtim të fshatit të Koretishtës, saktësisht afër furrës Dora duke mos përshtatur shpejtësinë mjetit të tij e kushteve të rrugës godet këmbësoret H. K. dhe E. K. të cilat ishin duke lëvizur skajit të rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes, të cilat pësojnë lëndime të trupore të përshkruara si në dokumentacion, e që si pasojë e këtij aksidenti e njëjta E. K. ka pësuar lëndime të lehta trupore edhe atë lëndim të lehtë truporë në formë të ndrydhjeve të kokës dhe trupit pastaj gërvishitje në regjionin gluteal majtas dhe frontal majtas që specialisti i ORL-së e ka përshkruar si plagë çarëse ndrydhëse, dhe ka patur dhimbje edhe atë: dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë ka pasur 20 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë ka pasur 24 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm ka pasur për 14 ditë (koha e nevojshme për rikuperimin e organizmit nga lëndimet e lehta trupor dhe plagët prerëse), dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka pasur për rreth një muaj pas aksidentit, gjatë sforcimit fizik dhe ndryshimeve klimatike, shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të lehtë për shkak të vrazave të mbetura në mes të vetullave 0,5 cm, në cepin e syrit të majtë 1cm dhe mbi gjurin e majtë 3cm, nuk ka zvogëlimi të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe si pasojë e këtij aksidenti e njëjta ka pësuar frikë edhe atë frikë primare të intensitetit të lartë ka pas 2- 3 minuta, frikë të intensitetit të lartë 2-3 orë, frikë të intensitetit mesatar- frikë sekondare ka pasur 2 javë. Pasoja të mëvonshme ka pasur manifestim të stresit akut, probleme me gjumin herë pas here si dhe brengosje, ku këto shihen në bazë të ekspertizave mjekësore edhe atë të Dr.Qemajl Rexhepi – psikiatër e datës 08.03.2017 dhe Dr.Xhemajl Selamani-Ortoped e datës 09.08.2017.

6.2.Gjithashtu si pasojë e këtij aksidenti lëndime të rënda trupore ka pësuar edhe paditësja Hide Kosumi siç shihet edhe nga: ekspertiza e ekspertit Ortoped- traumatolog i dt. 09.08.2017, ku si rezultat i tyre e njëjta ka pësuar ndrydhje të kokës me plagë prerëse në regjionin zverkor të djathtë, ndrydhje me gjakmbledhje në regjionin e belit, thyerje e platosë tibiale të gjurit të djathtë, lëndimi trupor karakterizohet si lëndim i rëndë, dhe ka patur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë 40 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë për 48 orë kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë

adekuate, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 42 ditë koha e nevojshme për fillimin e konsolidimit primar kockor – në raport me moshën, dhimbje fizike të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj dite të cilat manifestohen si dhimbje të vazhdueshme të belit (kryqëza) dhe gjurit të djathtë, dhimbje koke me ushtimë të cilat shtohen gjatë sforcimit fizik dhe ndryshimeve klimatike, shëmtimi trupor është i shprehur në shkallë të mesme për shkak të vrajave të mbetura në pjesën zverkore të djathtë të kokës me gjatësi 3cm dhe vraja operatore e gjurit të djathtë me gjatësi prej 12 cm, zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është i shprehur në shkallën prej 15%, për shkak të artrozës së gjurit të djathtë me kufizim të lëvizjeve të tij në shkallë të mesme- pika 2.3.3 b e tabelës mbi zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, dhe si rezultat i këtij aksidenti e njëjta kë pësuar frikë edhe atë frikë të intensitetit shumë të lartë- frikë primare 3-4 minuta, frikë të intensitetit mesatar- frikë sekondare 2 javë, manifestim të stresit akut, probleme të gjumit herë pas here, probleme me harrës janë prezent, probleme me përqendrim ndonjëherë, nevojë të mëtejshme për trajtim mjekësor herë pas here me terapi fizikale, ku këto shihen në bazë të ekspertizave mjekësore edhe atë të Dr.Qemajl Rexhepi – psikiatër e datës 05.10.2017 dhe Dr.Xhemajl Selamani-Ortoped e datës 09.08.2017.

6.3. Andaj, gjykata e detyroi të paditurën **si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi** që paditëseve t'ia kompensoj shumën edhe atë për paditësen e parë H. K. në emër të dëmit jo material shumën prej 11,500.00 € në formë të satisfaksionit për dhimbjet e përjetuara fizike ashtu që e njëjti të bëjë ekuilibrimin e gjendjes së saj shpirtërore dhe sado kudo që t'i menjanoj edhe pse është e pa mundur dëmtimin e së mirës së saj dhe kjo lartësi i shkon për shtati synimeve të natyrës së saj dhe qëllimit shoqëror për kompensimin e dëmit duke pasur parasysh mendimin e ekspertit ortoped dhe psikiatër lidhur me intenzitetin e dhimbjeve dhe frikën që e ka përjetuar me rastin e shkaktimit të aksidentit ku paditësja kanë qenë e dëmtuar, e cila sipas mendimit të ekspertit ortoped ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe e njëjta për shkak të aksidentit ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor edhe atë në shkallë prej 15%, dhe për paditësen e dytë E. K. në emër të dëmit jo material shumën në lartësi prej 4,500.00 € në formë të satisfaksionit për dhimbjet e përjetuara fizike, duke e marrë për bazë faktin se e njëjta është në moshë të re e gjithashtu duke pasur parasysh mendimin e ekspertit ortoped dhe psikiatër lidhur me intenzitetin e dhimbjeve dhe frikën që e ka përjetuar me rastin e shkaktimit të aksidentit ku paditësja ka qenë e dëmtuar.

6.4.Gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses H. K. **si në dispozitivin e II të këtij aktgjykimi** sa i përket dëmit jo material të kërkuar në lartësi prej 5,500.00 €, më shumë se shumat e gjetuara, i refuzoi si të pabazuara duke marrë parasysh edhe praktikën gjyqësore në caktimin e lartësisë së detyrimeve për rastet e njëjta dhe e cila është shumë e lartë dhe nuk përkon me interesin dhe rëndësinë-qëllimit të shkeljes së të mirës së paditëses.

6.5. Gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses H. K. **si në dispozitivin e III të këtij aktgjykimi** sa i përket ndihmës për personin e tretë dhe ushqimit të përforcuar pasi që këto dy forma të dëmit paraqesin dëmë material dhe duhet të vërtetohen me prova përkatëse dhe jo vetëm me një mendim të ekspertëve mjeko-ligjor. Paditësja gjykatës nuk i ka sjellur provat me të cilat do të vërtetonte se për të është përkujdesur dikush, përkatësisht ndonjë person i tretë dhe nuk është vërtetuar se këto shërbime të personit të tretë i ka shfrytëzuar paditësja (personi konkret i cili është përkujdesur) dhe sa ka paguar paditësja për shërbimet e bëra. Poashtu edhe për ushqimin e përforcuar, gjykata kërkesë padin e paditëses për këtë formë të dëmit material e ka refuzuar si të pabazuar pasi që paditësja nuk i ka sjellur gjykatës provat me të cilat do të vërtetonte se ka shfrytëzuar ushqim më kualitativ në krahasim me ushqimin e përditshëm dhe faturat me të cilat do të vërtetonte se e ka paguar këtë

ushqim të përforcuar. Andaj, gjykata duke u nisur nga të lartëcekurat vjen në përfundim se dëmi material për këto dy forma (ndihma dhe kujdesi i personit të tretë dhe ushqimi i përforcuar) duhet të provohen me prova për shfrytëzimin e tyre dhe pagesat e bëra për to, prandaj në mungesë të provave kërkesë-padin e ka refuzuar si të pabazuar.

6.6. Gjykata pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses E. K. *si në dispozitivin e IV të këtij aktgjykimi* sa i përket dëmit jo material të kërkuar në lartësi prej 1,500.00€, më shumë se shumat e gjuhuara, i refuzoi si të pabazuara duke marrë parasysh edhe praktikën gjyqësore në caktimin e lartësisë së detyrimeve për rastet e njëjta dhe e cila është shumë e lartë dhe nuk përkon me interesin dhe rëndësinë-qëllimit të shkeljes së të mirës së paditëses duke shtuar faktin se e njëjta ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe fatmirësisht nuk ka zvogëlim të përhershëm të aktivitetit jetësor.

6.7. Gjykata e ka refuzuar kërkesadinë e paditëses E. K. *si në dispozitivin e V, të këtij aktgjykimi* sa i përket ushqimit të përforcuar dhe ndihmës së personit të tretë, pasi që këto dy forma të dëmit paraqesin dëm material dhe duhet të vërtetohen me prova përkatëse dhe jo vetëm me një mendim të ekspertëve mjeko-ligjor. Paditësja gjykatës nuk i ka sjellur provat me të cilat do të vërtetonte se për të është perkujdesur dikush, përkatësisht ndonjë person i tretë dhe nuk është vërtetuar se këto shërbime të personit të tretë i ka shfrytëzuar paditësja (personi konkret i cili është perkujdesur) dhe sa ka paguar paditësja për shërbimet e bëra. Poashtu edhe për ushqimin e përforcuar, gjykata kërkesë padin e paditëses për këtë formë të dëmit material e ka refuzuar si të pabazuar pasi që paditësja nuk i ka sjellur gjykatës provat me të cilat do të vërtetonte se ka shfrytëzuar ushqim më kualitativ në krahasim me ushqimin e përditshëm dhe faturat me të cilat do të vërtetonte se e ka paguar këtë ushqim të përforcuar. Andaj, gjykata duke u nisur nga të lartëcekurat vjen në përfundim se dëmi material për këto dy forma (ndihma dhe kujdesi i personit të tretë dhe ushqimi i përforcuar) duhet të provohen me prova për shfrytëzimin e tyre dhe pagesat e bëra për to, prandaj në mungesë të provave kërkesë-padin e ka refuzuar si të pabazuar.

6.8. Gjykata e detyroi të paditurën *si në dispozitivin e VI të këtij aktgjykimi*, që paditëseve t'ia kompensojnë shpenzimet gjyqësore në lartësi prej 969.00 €, konform nenit 452.1 të LPK edhe atë, për përfaqësim për një seancë sipas TA të Kosovës edhe atë në shumë prej 405€, duke marrë parasysh vlerën e objektit të kontestit mbi 10.000.00 Euro, 2 (dy) paditës i ka përfaqësuar av.Hamdi Jashari, ekspertizat mjekësore 300 euro (150 € për secilën), për taksë për padi 264 Euro, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

7.Dispozitat ligjore të aplikueshme

7.1.Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëseve, bazës juridike të padisë dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat materiale të LMD në fuqi /meqë raporti juridiko civil është krijuar në pas hyrjes në fuqi të këtij ligji/,prej ku rrjedh edhe baza e përgjegjësisë së të paditurës e në pajtim me nenet 136 , 159 dhe 174, lidhur me nenet 179 dhe 183, të LMD si dhe neneve 9 dhe 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia ndërsa procedura kontestimore u zhvillua në pajtim me dispozitat ligjore të LPK-së.

7.2. Të gjitha detyrimet e të paditurit lidhur me dëmin jo material, gjykata i gjuhuoi me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi edhe atë prej datë 26.10.2017 e deri në pagesën definitive, kurse sa i përket dëmit material duke filluar nga dita e shkaktimit të aksidentit me datë 07.08.2014 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm e duke u bazuar në nenin 382.1 dhe 2 të LMD/ Ligji Nr. 04/ L-077.

7.3.Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe provat tjera materiale, por ato ishin i relevante në vendosjen meritorë të kësaj çështje, ashtu që nuk u arsyetuan veç e veç.

7.4.Nga arsyet e cekura më lartë e bazuar edhe në nenin 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr 876/2014

Me datë 26.10.2017

Gjyqtari,
Sabedin Mushica

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.